



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë -Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 222/2023
Datë 12.12.2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në pajtim me nenin 323 (paragrafi 1), nenin 328 (paragrafi 1) dhe nenin 330 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin nr. 08/L-102, në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përmbartuesit privat

1. **Z. Agron (Shaban) Krasniqi**, emërohet përmbartues privat për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.
2. Selia e të emëruarit do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës Themelore në Ferizaj.
3. I emëruari, para caktimit të ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbartuese në pajtim me paragrafin 4 të nenit 331 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore është i obliguar që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e dhënies së betimit të ofroj dëshmitë se i plotëson kushtet sipas nenit 332 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni për vlerësimin e kandidateve për përmbaues privat, me datën 07.12.2023 ka mbajtur takim për vlerësimin e aplikacioneve të kandidateve për emërim për përmbaues privat në territorin e gjykatave themelore në Republikën e Kosovës.

Komisioni vlerësues pas vlerësimit të aplikacioneve dhe dokumentacionit të kandidateve ka përpiluar listën me propozime, dhe duke pas parasysh se për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pasur me shume kandidate për përmbaues, Komisioni duke u bazuar në nenin 329 (paragrafi 2) i cili përcakton se: *“Me rastin e përzgjedhjes në mes të më shumë kandidateve posaçërisht do të merret parasysh rezultati i tyre në provimin për përmbaues privat”*, meqenëse kandidatet tjerë kanë pasur rezultat më të mirë në provim për përmbaues privat, Komisioni vlerësues ka rekomanduar që Ju të ushtroni veprimtarin përmbauese për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në piken 1 të dispozitivit të këtij vendimi.


Albulena HAXHIU
Ministre e Drejtësisë

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij vendimi mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Vendimi iu dërgohet:

- Përmbauesit privat të emëruar;
- Odës së Përmbauesve Privat;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Departamentit për Profesione të Lira/MD;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.